



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**V E N D I M**

**Nr. 10, Datë 20/01/2020**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 149, datë 19.11.2019, e një grupi studentësh<sup>1</sup> përkatësisht Znj. D.R., Znj. Xh. Q., Znj. E. R., Znj. J. B.e Znj. Xh. S., që kanë përfunduar nivelin Bachelor, të Fakultetit Ekonomik, pranë Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan dhe Z. A. S., që ka përfunduar nivelin Bachelor, pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, ku pretendohet diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se grupi i studentëve të sipërpërmendur kanë aplikuar për të ndjekur

---

<sup>1</sup> Znj. D.R. ka përfunduar nivelin Bachelor në programin “Shkenca Juridike në Biznes”, pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan;

Znj. E. R. ka përfunduar nivelin Bachelor në programin “Shkenca Juridike në Sektorin Publik”, pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan;

Znj. Xh. Q. ka përfunduar nivelin Bachelor në programin “Shkenca Juridike në Biznes”, pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan;

Znj. Xh. S. ka përfunduar ka përfunduar nivelin Bachelor në programin “Shkenca Juridike në Biznes”, pranë Fakultetit Ekonomik, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan;

Znj. J. B.ka përfunduar nivelin Bachelor të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan;

Z. A. S. ka përfunduar vitin e tretë në Fakultetin e Shkencave Juridike dhe marrëdhënieve Ndërkombëtare, në programin e Shkencave Juridike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, pranë Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Programin e Ciklit të Dytë të Studimeve pranë Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë. Pretendimi i tyre mbështetet në faktin se pavarësisht mesatares së tyre mbi notën 8, ata nuk janë përzgjedhur për të ndjekur nivelin Master Shkencor (Civil, Penal apo Publik), sipas preferencës së gjithsecilit prej tyre në aplikimet përkatëse, por janë përzgjedhur për të ndjekur Master Profesional pranë këtij fakulteti.

Në ankesë theksohet fakti se kriteret e pranimit për ndjekjen e Programit të Ciklit të Dytë në Fakultetin e Drejtësisë, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2019-2020<sup>3</sup> janë përkatësisht nota mesatare minimale 6.5 për Master Shkencor dhe nota mesatare minimale 6.0 për Master Profesional. Pavarësisht sa më sipër, ata vënë në dukje faktin se fitues për nivelin Master Shkencor, pranë këtij fakulteti kanë qenë studentë me mesatare më të ulët, se mesatarja e tyre.

Ata shprehen gjithashtu se një përzgjedhje e tillë është diskriminuese edhe sepse ata janë studentë që kanë përfunduar ciklin Bachelor në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe në universitete private.

Njëkohësisht, grupi i studentëve ankues vënë në dukje faktin se kanë depozituar ankesë me shkrim pranë Fakultetit të Drejtësisë, duke kërkuar shpjegime për sa më sipër, por nuk u është kthyer përgjigje me shkrim nga ana e këtij fakulteti.

#### **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 149, datë 19.11.2019, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë dhe për dijeni grupit të studentëve ankues, me shkresën nr.1757/1, datë 27.11.2019, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
  - Akti administrativ, që ka përcaktuar kuotat mbi numrin e fituesve për Programin e ciklit të Dytë të Studimeve pranë Fakultetit të Drejtësisë, për vitin 2019-2010;

<sup>3</sup> Në referencë të Vendimit nr. 27, datë 10.09.2019, të Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë Tiranë.

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Lista e aplikuesve për Programin e Ciklit të Dytë të Studimeve pranë Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë;
  - Lista e fituesve për Programin e Ciklit të Dytë të Studimeve pranë Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë, ku të jenë grupuar në mënyrë të veçantë fituesit (me mesataren e notave) në programin Master Shkencor dhe Master Profesional;
  - Informacion mbi numrin e fituesve nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe universitetet private, në programin e ciklit të dytë të studimeve, (master shkencor), pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë;
  - Formularët e aplikimit të studentëve ankues për Programin e Ciklit të Dytë të Studimeve, pranë Fakultetit të Drejtësisë;
  - Informacion se për cilin Program Studimi të Ciklit të Dytë është përzgjedhur secili prej tyre;
  - Kopje e ankesave me shkrim të grupit të ankuesve, si dhe përgjigjeve zyrtare të Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë.
  - Kopje e Vendimit nr. 27, datë 10.09.2019, të Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë;
1. Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë nuk i dërgoi përgjigje shkresës nr.1757/1, datë 27.11.2019, së Komisionerit.
  2. Në vijim, Komisioneri iu drejtua sërisht Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë nëpërmjet shkresës nr. 14, datë 07.01.2020, ku i bën kujtesë për t'i kthyer përgjigje shkresës paraardhëse brenda datës 14.01.2020.
  3. Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, Fakulteti i Drejtësisë dërgoi shkresën nr. 14/1, datë 14.01.2020, nëpërmjet së cilës informon si më poshtë vijon:
    - Znj. D.R. është regjistruar si fituese në programin e studimit Master Profesional Publik pranë FDUT, në datën 25.11.2019;
    - Znj. Xh. Q. është regjistruar si fituese në programin e studimit Master Profesional Publik pranë FDUT në datë 25.11.2019;
    - Znj. Entela Rabushaj është regjistruar si fituese në programin e studimit Master Shkencor Publik pranë FDUT në datë 18.12.2019;
    - Znj. Xh. S. është regjistruar si fituese në programin e studimit Master Profesional Civil pranë FDUT, në datën 25.11.2019;
    - Z. A. S. është regjistruar si fitues në programin e studimit Master Profesional Publik pranë FDUT, në datën 19.12.2019;
    - Znj. J. B. është shpallur fituese në programin e studimit Master Profesional Publik pranë FDUT, por nuk rezulton e regjistruar si fituese;

Në lidhje me dokumentacionin e kërkuar nga KMD, Dekani i Fakultetit Juridik sqaron se aktet e kërkuara janë të publikuara në website [www.fdut.edu.al](http://www.fdut.edu.al) prej muajit shtator 2019 dhe trajtimi i aplikantëve është kryer sipas kritereve të përcaktuara në aktet e publikuara.

Njëkohësisht, në shkresën e këtij institucioni arsimor sugjerohet që, në kushtet kur, ankuesit aktualisht janë studentë të FDUT, të pyeten nëse i qendrojnë pretendimit të diskriminimit për shkak të gjendjes arsimore nga ana e këtij fakulteti,

4. Shkresa nr. 14/1, datë 14.01.2020, e Fakultetit të Drejtësisë, Tiranë erdhi në vijim të e-maileve të dërguara në adresë të Komisionerit, nga studentët ankues, të cilët kërkuan tërheqjen e ankesës kundër këtij fakulteti<sup>5</sup>.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 17, 19 e 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Përfundimin e proçedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 149, datë 19.11.2019, pasi grupi i ankuesve ka depozituar kërkesë për tërheqje të ankesës pranë KMD-së.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

Shkak – gjendja arsimore  
Fusha - arsim

---

<sup>5</sup>E-mailet e studentëve ankues u dërguan në adresë të KMD-së, përkatësisht në datat 10.01.2020 dhe 13.01.2020;